

VENDIM
Nr. 36, datë 27.3.2024

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 361, DATË 7.12.2023, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘GEALB ENERGY’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET ‘GURI I BARDHË 1’ DHE ‘GURI I BARDHË 2’”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.3.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 650/1 prot., datë 12.3.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 361, datë 7.12.2023, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Gealb Energy’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet ‘Guri i Bardhë 1’ dhe ‘Guri i Bardhë 2’””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 361, datë 7.12.2023, ka licencuar shoqërinë “Gealb Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Guri i Bardhë 1”, “Guri i Bardhë 2”, me kapacitet të instaluar 9300 kw, për një afat 28 vjet e 5 muaj, duke i lënë kusht shoqërisë që të informojë ERE-n, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të hidrocentraleve brenda datës 3.2.2024, në rast se nuk ka filluar ende punimet atëherë të depozitojë VNM e rinovuar brenda kësaj date.

- Shoqëria është njoftuar për këtë vendim me shkresën nr. 2042/18 prot., datë 7.12.2022. Me me *email*-in e protokolluar në ERE me nr. 650 prot., datë 16.2.2024, shoqëria ka bërë me dije se nuk ka filluar ende punimet për ndërtimin e HEC dhe në rrethanat kur afati i deklaratës mjedisore tashmë ka përfunduar, ajo po përgatit aplikimin për një deklaratë të re, pasi legjislacioni mjedisor nuk parashikon rinovim, por aplikim nga e para, duke marrë angazhimin për të informuar ERE-n, në lidhje me aplikimin për lejen e re mjedisore.

- Duke qenë se në marrjen e vendimit nr. 361, datë 7.12.2023, shoqëria dispononte deklaratë mjedisore të vlefshme, i është lënë kushti përkatës për raportimin e fillimit të punimeve ose depozitim të deklaratës së rinovuar/të re, por duke marrë në konsideratë se shoqëria nuk filloi punimet brenda afatit të vlefshmërisë së saj e nuk është pajisur ende me një deklaratë të re, vlerësohet të ndryshohet pika 2 e këtij vendimi dhe t’i lihet kusht asaj të depozitojë në ERE deklaratën mjedisore të re sapo ta disponojë, e gjithashtu në rrethanat kur nuk disponon më një deklaratë të vlefshme mjedisore, të vendoset kushti që ta depozitojë atë në ERE përpara fillimit të operimit/ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

- Në nenin 10, të kontratës së koncesionit të formës BOT, me nr. 1139 rep., nr. 437 kol., datë 21.4.2017, nënshkruar mes Ministrinë së Energjisë dhe Industrisë e shoqërisë “Gealb Energy” sh.p.k., ndryshuar me kontratën shtesë të koncesionit nr. 890 rep., nr. 263 kol., datë 28.3.2022, përcaktohet se afatet për ndërtimin e veprës mund të ndryshohen me marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt procedurale për marrjen e tyre.

- Për sa më sipër cituar, e duke qenë se gjatë licencimit shoqëria ka bërë me dije se nuk i kishte nisur ende punimet dhe ishte në fazën e marrjes së miratimit nga MIE për shtyrjen e afatit të marrjes së lejeve dhe miratimeve të nevojshme për projektin, në referencë të përcaktimeve të kontratës së koncesionit të sipërcituar, vlerësohet që po ashtu t’i lihet kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE miratimin/qëndrimin përkatës të ministrisë, për zgjatjen e afatit të fillimit të punimeve/ndërtimit të hidrocentraleve “Guri i Bardhë 1” dhe “Guri i Bardhë 2” përpara fillimit të operimit.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 361, datë 7.12.2023, ndryshon dhe bëhet:
2. Përpara fillimit të operimit/ushtimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, shoqëria “Gealb Energy” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE:

a) deklaratën mjedisore të re;
b) miratimin/qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me zgjatjen e afatit të fillimit të punimeve/ndërtimit të hidrocentraleve “Guri i Bardhë 1” dhe “Guri i Bardhë 2”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Gealb Energy” sh.p.k., OST sh.a. dhe FTL sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi